



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

KPPP.nr. 1559/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtarja Vera Gashi Bala, në çështjen përmbartimore të kreditorit Kompania e Sigurimeve “Illyria” sh.a. me NUI 810483769, bulevardi “Nëna Terezë” nr.33, Prishtinë, kundër debitorit “ER-Lis” Sh.p.k., me nr. të biznesit 71205223, dhe nr. fiskal: 60152811, Vitomiricë RIII, Pejë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar ndaj Urdhrit Përmbartimor P.nr.090/22, të datës 23.02.2022, i caktuar nga Përmbartuesi Privat, Kushtrim Metaj, me seli në Prishtinë, jashtë seancës, me datë 28.07.2023, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi i pa bazuar prapësimi i debitorit “ER-Lis” Sh.p.k., me nr. të biznesit 71205223, ushtruar ndaj Urdhrit Përmbartimor P.nr.090/22 të datës 23.02.2022, të Përmbartuesit Privat Kushtrim Metaj.
- II. Urdhri Përmbartimor P.nr.090/22 i lejuar me datë 23.02.2022, nga Përmbartuesi Privat Kushtrim Metaj, MBETET NË FUQI.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “Illyria” sh.a. me NUI 810483769 mbi bazën e dokumentit të besueshëm- Faturë me nr. 8787/19 në shumë prej 92.68 euro, me afat të pagesës 16.02.2019, ka lejuar përmbartimin ndaj debitorit, me shumë prej 92.68 Euro, shtesë shpenzimet e procedurës përmbartimore, të gjitha këto në afat prej shtatë ditëve së bashku me kamatën ligjore nga dita kur kërkesa është bërë e arritshme me ndalimin e mjeteve të cilat debitori i ka në ndonjërin nga bankat afariste në Kosovë, në të cilat banka debitori e ka të hapur xhirollogarinë e vete.

Kundër këtij urdhri, me datë 11.03.2022 prapësim ka paraqitur debitori, me të cilën e ka kundërshtuar urdhrin përmbartimor për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të

procedurës përmbartimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale. Tutje thekson se urdhri nuk mund të ekzekutohet me arsyetimin se me kreditorin kanë pasur kontratë që të gjitha pagesat të bëhen nga llogaria e debitorit në Banka Ekonomike dhe e njëjta sipas meje është bërë. Tutje shton se urdhri është lejuar vetëm në bazë të provave të prezantuara nga kreditori dhe nuk ka marrë për bazë ankesën gojore të debitorit të cilën e ka drejtuar tek kreditori dhe me email në adresën e debitorit, dhe pa lexuar kontratën dhe konfirmimin e debitorit. Shton se për të njëjtën kontratë posedon 3 kontrata, Polica të cilat edhe i ka bashkangjitur në prapësim dhe kartela e Klientit – për pagesat e pranimit. Nga gjykata ka kërkuar që ta aprovon prapësimin si të bazuar dhe të hapë shqyrtimin gjyqësor apo ta hedh të njëjtin me arsyetimin e gabimeve të kreditorit dhe të ndryshoj urdhrin përmbartimor P.nr.163/22

Kreditori, përmes postës elektronike, me emali, me datë 16.03.2022 ka konfirmuar pranimin e prapësimit të debitorit duke shtuar se prapësimi është bërë vetëm me qëllim të prolongimit të pagesës së borxhit nga ana e debitorit. Tutje shton se arsyet e paraqitura nuk kanë mbështetje as ligjore as faktike andaj e shohim të paarsyeshme të përpilojmë përgjigje pasi që në propozim kemi parashtruar gjithçka lidhur me kërkesën tonë.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes së kreditorit në prapësim, dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 lidhur me nenin 71 par. 1.1 të Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore (LPP), gjeti se prapësimi i debitorit nuk është i bazuar andaj e refuzoi si të tillë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29, paragrafi 1 të LPP-së, *“Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa, në pikën 1.3 të të njëjtit nen, *fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm sipas të cilit mund të caktohet përmbartimi për realizimin e kërkesës në të holla*. Tutje, me paragrafin 3 të nenit 29 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*. Në anën tjetër, neni 37 i LPP-së, përcakton se *“Kur propozimi për përmbartim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t'i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit”*.

Gjykata vlerëson se urdhri i lejuar nga ana e përmbaruesit privat bazohet në dokumentin e besueshëm – përkatësisht faturën e lartcekur e cila i përmban të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm siç kërkohet me nenin 29, paragrafi 3 të LPP-së, për arsye se në faturë janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë emërtuar mallrat me të cilat është shërbyer debitori, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi. Gjithashtu, fatura mbi bazën e të cilës është lejuar urdhri përmbarimor është paraqitur në origjinal, është e nënshkruara dhe vulosura nga debitori dhe se pranimi i të njëjtës nuk kundërshtohet nga debitori në prapësimin e tij.

Gjykata, vlerësoj pretendimet e debitorit të ngritura në prapësim se pagesat janë realizuar por gjeti se i njëjti nuk ka ofruar asnjë provë në kuptim të nenit 69.4 të LPP-së për t'i mbështetur pretendimet e tilla, e rrjedhimisht nuk ekziston asnjëra nga shkaqet e parashikuara me nenin 71 të LPP-së mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbarimit, ndërsa në kuptim të nenit 73 të LPP-së, lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Nga arsyet e paraqitura më lart dhe duke u bazuar në nenin 73, paragrafi 3 të LPP-së, nenin 13, paragrafi 1, nën paragrafi 1.2, dhe Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr 1559/22, datë 28.07.2023

Gjyqtarja

Vera Gashi Bala

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.